



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
NJESIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 723 Prot.

Kuçovë, më 13 / 02 / 2026

RAPORTI VJETOR I NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
NE BASHKINE KUÇOVE PER VITIN 2025

Raprti Vjetor i veprimtarise se Njesise se Auditimit te Brendshem bashkia Kucove, përmban një pasqyrë të plotë të veprimtarisë së kesaj Njësie gjatë vitit raportues 2025 dhe hartohet në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale të auditimit të brendshëm

Struktura e Raportit Vjetor te Njesise se Auditimit te Breshem ne bashkine Kucove per vitin 2025, vjen sipas implementimit te ndryshimeve te percaktuara ne Manualin e Auditimit te Brendshem miratuar me Urdherin e Ministrit te Financave nr.134 date 17.10.2025 dhe eshte konfiguruar sipas permbajtjes vijuese:

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

II. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

III. REALIZIMI I PLANIT VJETOR TË AUDITIMEVE

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

V. VLERËSIMI I IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE

VI. VLERËSIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIT TË RISKUT

VII. PROGRAMI I SIGURIMIT TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL

VIII. PASQYRA SHOQËRUESE TË TË DHËNAVE

..

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor i veprimtarise se Njesise se Auditimit te Brendshem ne bashkin Kucoves per vitin 2025, si nje angazhim final komunikimi raportimi,dhe si nje detyrim ne zbatim te pikes *ç te nenit 14 te ligjit nr. 114 dt 22.10.2015 "Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik"* paraqet informacion sintetik,lidhur me realizimin e detyrave dhe nivelin e arritjes së objektivave të Nj.A.B në Bashkinë Kucove për vitin 2025, trajton menaxhimin e burimeve njerezore, atyre dokumentare e materiale ne dispozicion, vlereson treguesit dhe matesit e performances dhe pasqyron shkallen e pajtuesmerise me standardet profesionale te auditimit te brendshem. Ne kete kendveshtrim, Raporti eshte ne pajtuesmeri me kerkesen per realizim te pergjegjesive nga audituesit e brendshem, dhe ne perputhshmeri me formatin e kerkuar normativisht.

- Qëllimi i raportit

Ky Raport ka per qellim te ofroje nje pasqyre te qarte e gjithepershiresë te funksionimit dhe aktivitetëve gjate vitit raportues 2025, me synimin te informoje Kryetarin e bashkise Kucove dhe Strukturen Pergjegjese per Harmonizimin e Auditimit te Brendshem ne MF, mbi progresin dhe rezultatet e arritura ne fushen e auditimit te brendshem; vleresoje efektivitetin e sistemeve te kontrollit te brendshem dhe menaxhimit te riskut; identifikojë mangesite ne proceset dhe praktikat ekzistuese ne njesite e audituara dhe te propozojë masa dhe rekomandime per permiresimin e vazhdueshem te veprimtarise dhe menaxhimit te bashkise Kucove.

- Përmbledhja e aktivitetëve kryesore të NJAB Kucove gjate vitit 2025:

Për vitin 2025, me Planin Vjetor te NJAB per vitin 2025 te miratuar nga Kryetari i Bashkise me nr.3501 prot date 15.10.2024, ishin planifikuar për tu realizuar 6 angazhime auditimi nga te cilat 5 jane subjekte(njese) te bashkise dhe 1 mision auditimi per verifikimin e zbatimit te rekomandimeve te dhena ne auditimet e meparshme te vitit 2024. Nepermjet organizimit dhe zhvillimit te pergjegjshmerise se punonjesve te NJAB, gjate vitit 2025 janë realizuar po 6 misionet e programuara nga NJAB Kucove, nderkohe duke qene koshiente per sfiden e tejkaluar,per arsye se dy specialistet auditues vijuan te jene te pacertifikuar.

Subjekte te audituara nga NJAB Kucove për vitin 2025 janë si më poshtë:

1. Drejtoria e Qendres Kulturore;
2. Inspektorati Vendor I Mbrojtjes se Territorit;
3. Zbatimi I Rekomandimeve te dhena ne Auditimet e meparshme;
4. Sektori I Prokurimeve Publike;
5. Qendra Ekonomike e Arsimit;
6. Drejtoria e te Ardhurave Vendore.

- Përmbledhja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet e konstatuara ne subjektet e audituara jane ne sistemet:

- *Gjetjet ne sistemet e kontrollit te brendshem e menaxhimit*, kryesisht ne mungesen e njohjes se thelluar dhe mos implemtimit korrekt te legjislecionit te MFK, si ne evidentimin e riskut dhe ndertimit te nje strategjie per reduktimin e nivelit te ndikimit te

tij ne arritjen e objektivave, ne percaktimin e aktiviteve te kontrollit dhe ne raportimin e monitorimin e veprimtarise sektoriale.

- *Gjetjet ne sistemet e qeverisjes e administrimit*, dhe me kryesihet ne mos hartimin e me pas te miratimit te permiresimeve dhe perditimit te “Rregullores se Brendshme te organizimit dhe funksionimit te administrates se bashkise Kucove”, pasi ndryshimet ne strukture dhe fusheveprim te pa azhornuara si dhe dinamika e legjislacionit e paperditesuar, ka sjelle mosfunksionim efektiv te njesive dhe mos ushtrim i detyrave funksionale si duhet te punonjesve te subjekteve te audituara.
- *Gjetje ne sistemin e prokurimeve*, e me kryesisht ne mostrajnimin e personit pergjegjes per prokurimet, mangesi ne dokumentimin/administrimin per procedurat e prokurimit specifikisht per prokurimet me vlere te vogel; mosinventarizim dhe mosarkivim si kerkohe per dosjet e prokurimeve.
- *Menaxhimit te aktiveve*, e kryesihet ne: mosdokumentimin si duhet te aktivave ne perdorim mangesi ne procedurat per matjen e pervitshme te normativave te konsumit te lendeve djegese; menaxhim me risk i mbajtjes dhe marjes se aktiveve ne administrim nga njesia(abstrakte) apo nje person i vetem i gjithe inventarit ne perdorim.
- *Gjetje ne sistemin e te ardhurave*, e kryesisht: ne mosrealizimin e programit te planifikuar te te ardhurave vendore; ne mos aplikimin deri ne fund te masave shtrenguese te parshikuara ne ligjin e procedurave tatimore, per subjektet debitore.
- *Te ndryshme te dala gjate auditimeve*, e kryesisht ne : fushen e organizimit te aktiviteve te percaktuara, mungeses se ngritjes se Bordit te Kultures prane Qenderes Kulturore konform kerkesave te legjislacionit te artit e kultures; mungesa ne plotesine e dosjeve te personelit dhe mungesa te sigurise se administrimit te tyre;

Rekomandimet kryesore te dhena nga auditimet ne vitin 2025:

Nga 6 auditimet e kryera gjate vitit 2025, janë lënë në total 51 rekomandime nga të cilat:

- 19 rekomandime për përmirësim të sistemeve
- 0 rekomandime për përmirësim të kuadrit ligjor
- 18 rekomandime të karakterit organizativ
- 0 rekomandime për arkëtim
- 14 rekomandime të natyrave të tjera

Subjektet e audituara i kane pranuar 100% rekomandimet e dhena ne Raportet Finale dhe pergjithesisht subjektet e audituara, i janë përgjigjur rekomandimeve të auditimit për korrigjimin e gjetjeve dhe parregullsive, duke hartuar dhe miratuar Plan-veprimin ne zbatim te rekomandimeve, duke qene te bindur se zbatimi I tyre do te ndihmoje menaxhimin e ketyre subjekteve në përmirësimin e veprimtarise se subjekteve te audituara dhe arritjen e objektivave te caktuara..

Ne programin e auditimeve per vitin 2025, ishte planifikuar dhe angazhimi i auditimit per verifikimin e zbatimit te rekomandimeve te lena ne vitin 2024. Ky mision auditimi u relaizua ne muajin maj 2025, dhe nga ku rezultoi se nga 72 rekomanime te propozuara e te pranuar nga subjektet e audituara 100 % e tyre, kemi kete tablo: -18 rekomandime apo 25 % e totalit jane realizuar:- janë zbatuar pjesërisht 14 masa ose 22_% e totalit të masave të pranuar, -janë në proces zbatimi 37 masa ose në masën 51_% dhe rekomandime te pa zbatuar rezultuan 3_masa ose 2_% e totalit te rekomandimeve.

- Vlerësimi i përgjithshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm ka funksionuar pjesërisht efektiv, me mangësi në krijimin dhe zbatimin e procedurave ose në dokumentimin e veprimeve, por me risk të moderuar në arritjen e objektivave. Gjetjet/mangësitë e konstatuara kanë pasur një ndikim relativisht të konsideruar jo prioritar në veprimtarinë e subjekteve të audituara gjatë vitit 2025.

- Opinion i përgjithshëm mbi gjendjen e kontrollit të brendshëm

Për vitin 2025, në të gjitha subjektet e audituara, nga ana e Grupeve të Auditimit të NJAB Kucove, është bërë edhe vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm, procedurave të vendosura për funksionimin efektiv të këtij sistemi. Në përfundim të rezultateve të auditimeve, mbështetur në informacione të mjaftueshme, të besueshme, të duhura dhe të dobishme, Sektori I AB shpreh opinionin e përgjithshëm mbi “Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”

Niveli 3- **Sistem Pjesërisht Efektiv:**

“Sistemi i Kontrollit të Brendshëm nuk funksionon plotësisht në mënyrë efektive/mirë dhe ka nevojë për përmirësime të rëndësishme, thelbësore”.

Portokalli -

portokalli

II. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI NJËSINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM:

- Struktura organizative e NJAB Kucove:

Njesia e Auditimit të Brendshëm në bashkinë Kucove është organizuar si njësi (**Sektor**) me vete, ka varesi organizative dhe funksionale të drejtpërdrejta nga Kryetari i Bashkisë. Sektori i Auditimit të Brendshëm ushtron veprimtarinë e tij audituese në bashkinë Kucove dhe njesitë e varesisë të saj dhe raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë të Kryetari i Bashkisë (ende nuk është organizuar Komiteti i Auditimit të Brendshëm në këtë bashki).

Struktura organizative e këtij Sektori për vitin 2025, e miratuar me Vendim të Keshillit Bashkiak Kucove nr.71 datë 23.12.2024, ishte përcaktuar me 3(tre) punonjës. Kjo në përputhje me numurin minimal të audituesve të përcaktuar në ligjin nr.114/2015 “Per auditimin e brendshëm në sektorin public” dhe pjesërisht në përputhje me VKM nr.83/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të NJAB në sektorin public”. Sa me sipër për vitin 2025, NJAB-ja Kucove ka funksionuar me: 1(një) Përgjegjësi i Sektorit të A.B dhe 2(dy) specialiste auditimi.

- Personeli dhe kualifikimet profesionale

Arsimi profesional i punonjësve është: 1 ekonomist finance; 1 juriste dhe 1 ekonomiste financë-kontabilitet, në përputhje me kriteret e përcaktuara me përkrahjet e vendeve të punës që aplikohet për strukturat e auditimit.

Pergjegjesi I Sektorit eshte I certifikuar si “Auditues I Brendshem” , nderkohe qe dy audituese vijojne te jene të pa çertifikuara.

- Kapacitetet teknike dhe zhvillimi profesional gjatë vitit 2025:

Niveli i kapaciteteve teknike dhe atyre profesionale eshte ne kondicionin “Kenaqshem”, pasi kane pervoje relativisht te pakot ne auditim, nje specialiste eshte dhe me pervoje te reduktuar te profesionit, nderkohe qe sic eshte shprehur me siper, te dy specialistet audituese nuk kane kryer Programin e certifikimit per “Auditues i Brendshem”. Raportojme qe per vitin 2025, nga te 3 punonjesit e NJAB Kucove jane ndjekur rregullisht Trajnimet e vijueshme profesionale dhe cdo thirrje e bere nga DH/AB ne MF.

III. REALIZIMI I PLANIT VJETOR TË AUDITIMEVE

Për vitin 2025, sipas “Planit Vjetor të veprimtarise se NjAB-se per vitin 2025”, I konsultuar paraprakisht e me pas i miratuar nga Kryetari i Bashkisë Kucove me dokumentin nr.3501 prot dt 17.10.2024, ishin programuar 6(gjashte) angazhime auditimi gjithsej.

Nderveprimi i faktoreve ne terma sasiore e cilesore te burimeve njerezore ne dispozicion te cituara me siper, ka bere qe programi i vitit 2025, i planifikuar per te audituar 6(gjashte) subjekte te bashkise Kucove, te realizohej po per 6(gjashte) subjekte apo shprehur 100 % e planifikimit :

Nr.	Subjekt I Planifikuar / Audituar	Realizimi		Shpjegime
		Po	Jo	
1.	<i>Drejtoria e Qendres Kulturore</i>	Po		Auditim I kombinuar
2.	<i>Inspektorati Vendor I Mbrojtjes se Territorit</i>	Po		Auditim I Perputhshmerise
3.	<i>Zbatimi I Rekomandimeve te dhena ne Auditimet e meparshme</i>	Po		Auditim I Perputhshmerise
4.	<i>Spektori I Prokurimeve Publike</i>	Po		Auditim I Perputhshmerise
5.	<i>Qendra Ekonomike e Arsimit</i>	Po		Auditim I kombinuar
6.	<i>Drejtoria e te Ardhurave Vendore</i>	Po		Auditim I Perputhshmerise
	TOTALI	6(gjashte)		

Shmangiet nga Plani Vjetor

- Nuk ka patur gjate vitit 2025, misione auditime jashte atyre te planifikuara

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Në seksionin e **Gjetjeve dhe Rekomandimeve**, paraqiten përmbledhjet e rezultateve kryesore nga auditimet dhe rekomandimet e klasifikuara sipas nivelit të prioritetit.

- Përmbledhje e gjetjeve kryesore sipas fushave/procese të audituara :

- *Qeverisjes dhe administrimit*, kryesisht në :

- mos hartimin dhe miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Brendshme të administratës së bashkësisë pas riorganizimeve të tyre në vite, dhe dinamikës së legjislacionit në ndryshim;

- *Sistemi i Prokurimeve për :*

- Zhvillimin e procedurave për tenderat apo dhe procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, me disa mangësi dhe jo conform kriterëve ligjorë e normative
- .Mosmiratimi dhe përditësimin e Rregjistrit të Riskut për veprimtaritë kryesore të Sektorit si dhe hartimi i strategjisë së menaxhimit të tij
- Mos hartimi e miratimi i gjurmës specifike të auditimit për veprimtaritë kryesore të Sektorit të Prokurimeve.

-*Sistemi i Menxhimit të Ardhurave vendore për:*

- Mosndjekja permanente e detyrimeve ligjorë e fiskale për subjektet tatim-paguese që administrohen nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, specifikuat për bizneset, kategoria familjare si dhe fermerët sa i takon mardheniet me pronësine apo dhe qeradheniet e tokës bujqësore
- planifikimi sa më real dhe mosrealizimi i buxhetimit të të ardhurave, jo vetëm në total por dhe sipas kategorive e nenkategorive të taksapaguesve;
- Evidentimi dhe ndjekja e dinamikës së debitoreve dhe zbatimi i masave ligjorë shtrenguese

- *Sistemi i zbatimit të politikave vendore në fushën e arsimit parashkollor :*

- Mangësi në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit për vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e mangësive në veprimtarinë e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të frekuentimit të kopshte-cerdheve, si dhe mirembajtjes së infrastrukurës së arsimit parauniversitar;
- Mospërditësimi i kërkesave për përmirësimin dhe miratimin e rregullave specifike për menaxhimin shërbimeve në fushën e arsimit dhe në vecanti mardheniet kontraktuale me sipërmarrjet private;
- Ndjekja jo konsistente e detyrimeve ligjorë e fiskale për subjektet sa i takon mardheniet për faturat e furnizuesve si dhe detyrimet e familjeve për frekuentimin në kopshte-cerdhe

-*Sistemi i zbatimit të politikave vendore në fushën e mbrojtjes të territorit*

- Mungesa e formatimit të aktiviteteve të kontrollit për vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e mangësive në veprimtarinë e planifikimit dhe zhvillimit të territorit të bashkisë Kucovë;
- Ndjekja jo e mjaftueshme e detyrimeve ligjorë e fiskale për subjektet që pajisen me leje ndërtimi si dhe ato për legalizimin e ndërtimeve informale në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Urbanistikës së bashkisë Kucovë;

- Korelatimi I manget i dokumentacionit me IKMT dhe drejtorine rajonale perkatese dhe bashkepunimi me keta te fundit per mbrojtjen e administrimin e territorit te bashkise Kucove

- **Rekomandimet e dhëna**

Në sistemin qeverisjes dhe administrimi :

- Hartimin dhe miratimin e ndryshimeve ne Rregulloren e Brendshme të administrates se bashkise pas riorganizimeve të tyre ne vite, dhe dinamikës se legjislacionit ne ndryshim;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara, krijimin e “gjurmës së auditit” me proceset e detyrat e cdo punonjësi/ specialisti ne seicilen drejtori, për kordinimin e punës në kryerjen dhe monitorimin e shërbimeve.

Ne Sistemin e Prokurimeve për :

- Zhvillimin e procedurave për tenderat apo dhe procedurat e prokurimit me vlere te vogel, me pergjegjesi dhe conform kritereve ligjore e normative;
- .Miratimi dhe përditësimi i Rregjistrit të Riskut per veprimtarite kryesore te Sektorit te Prokurimeve si dhe hartimi I strategjise se menaxhimit te tij
- Hartimin e miratimin e gjurmes specifike të auditimit për veprimtarite kryesore te Sektorit te Prokurimeve;

-Sistemi I Menxhimit te Ardhurave vendore per:

- Ndjekja permanente e detyrimeve ligjore e fiskale per subjektet tatim-paguese qe administrohen nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore, specifikisht per bizneset, kategoria familjare si dhe fermeret sa I takon mardhenieve me pronesine apo dhe qeradheniet e tokes bujqesore
- planifikimi dhe realizimi I buxhetimit te te ardhurave, jo vetem ne total por dhe sipas kategorive e nenkategorive te taksapaguesve;
- Evidentimi dhe ndjekja e dinamikës se debitorëve dhe zbatimi I masave te plota ligjore shtrenguese

- Sistemi i zbatimit te politikave vendore ne fushen e arsimit parashkollor :

- Vendosjen e aktivitetëve të kontrollit për vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e mangësive në veprimtarine e ofrimit te shërbimit te menaxhimit te frekuentimit te kopshte-cerdheve, si dhe mirembajtjes se infrastructures se arsimit parauniversitar;
- Perditesimin, permiresimin dhe miratimin e rregullave specifike për menaxhimin shërbimeve ne fushen e arsimit dhe ne vecanti mardheniet kontraktuale me siper marrjet private:
- Ndjekja permanente e detyrimeve ligjore e fiskale per subjektet sa I takon mardhenieve per faturat e furnizuesve si dhe detyrimet e familjeve per frekuentimin ne kopshte-cerdhe

-Sistemi i zbatimit te politikave vendore ne fushen e mbrojtjes te territorit :

- Vendosjen e aktivitetëve të kontrollit për vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e mangësive në veprimtarine e planifikimit dhe zhvillimit te territorit te bashkise Kucove;
- Ndjekja permanente e detyrimeve ligjore e fiskale per subjektet qe pajisen me leje ndertimi si dhe ato per legalizimin e ndertimeve informale ne bashkepunim te ngushte me Drejtorine e Urbanistikes se bashkise Kucove;
- Korelatimi I dokumentacionit me IKMT dhe drejtorine rajonale perkatese dhe bashkepunimi me keta te fundit per mbrojtjen e administrimin e territorit te bashkise Kucove

- Prioriteti i rekomandimeve (i Lartë , i mesëm i ulët)

Rekomandime te dhëna në subjektet e audituara gjatë vitit 2025, të ndara sipas prioritetit janë si më poshtë:

- *Prioriteti i Lartë*, janë dhene 7 rekomandime;
- *Prioritet i Mesem*, janë dhene 36 rekomandime ;
- *Prioritet i Ulet*, janë dhene 9 rekomandime.

V. ECURIA E NDJEKJES SË REKOMANDIMEVE

Për vitin 2025, gjate veprimtarise audituese nga NJAB Kucove janë dhene gjithësej 51 rekomandime, nga të cilat :

-Rekomandime të përmirësimit e sistemeve është propozuar 19 rekomandime, te cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi. Rekomandimet janë kryesisht të njohjes dhe zbatimit nga strukturat e audituara te kriterëve ligjore ne fushen e MFK.Me konkretisht per evidentimin e riskut/qeve me te cilat perballen subjektet, menaxhimin e ndikimit te tyre dhe formesimin e strategjise ndaj riskut nepermjet hartimit dhe funksionimit te aktivitetëve te kontrollit, dhe përmirësimit e informimit dhe monitorimit .

-Rekomandime me karakter organizativ janë propozuar 18 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi. Keto rekomandime janë në process zbatimi për arsye te zoterimit nga strukturat e audituara te bazës ligjore e akteve normative e rregullatore, si dhe implementimi I tyre, duhet bere ne bashkërendim midis strukturave dhe nen drejtimin e Menxhimit te Lartet e Bashkise Kucove..

- Rekomandime per arketime janë propozuar 0 rekomandime me nje vlere 0 leke, te cilat janë pranuar nga menaxhimi I subjektit te adresuar.

-Rekomandime të tjera janë propozuar 14 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi.dhe mbeten në proces për shkak të procedurave qe duhen realizuar.

- Drejtimi I Nj.A.B kishte planifikuar per vitin 2025 dhe realizoi **me 1 angazhim auditimi specific**, “Auditimin për ndjekjen e rekomandimeve të auditimeve te meparshme”. Ne perfundim te ketij misioni rezultoi :

“Nga auditimi i ndjekjes se zbatimit te rekomandimeve në 5 subjektet e audituara ne vitin paraardhes 2024 janë rekomanduar gjithsej 72 masa, nga të cilat janë pranuar gjithsej po 72 masa ose në masën 100% . Verifikuam se, nga 72 masat e pranuar, - janë zbatuar plotësisht 18 masa ose në masën 25%,- janë zbatuar pjesërisht 14 masa ose 22% e totalit të masave të pranuar, -janë në proces zbatimi 37 masa ose në masën 51% dhe - pa zbatuar rezultuan 3 masa ose 2%. “.

VI. VLERËSIMI I SISTEMEVE TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIT TË RISKUT

- *Vlerësimi i përitshëm i funksionimit të kontrolleve*

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm ka funksionuar pjesërisht efektivisht,me disa mangësi në zbatimin e procedurave ose në dokumentimin e veprimeve, por pa risk të madh për objektivat


Gjetjet/mangësitë e konstatuara kanë pasur një ndikim të moderuar në objektivat e subjekteve/ të audituara. Kanevojë për përmirësim në disa fusha të veçanta në subjektet të audituara gjatë vitit 2025, për arritjen e objektivave të veprimtarisë.

- *Dobësitë e identifikuara në sistem*

Gjatë auditimeve të kryera në lidhje me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara është konstatuar:

- Nevoja për vendosjen e kontrolleve shtesë, për përmirësimin e linjave të autorizimit dhe raportimit; hartimin e rregullores së brendshme, rishikimin e strukture organizative, respektimin e regjimit arkivor në vite, në hartimin e gjurmës auditit, për veprimtarite kryesore, dokumentimin e levizjeve të inventarit .
- Në vlerësimet periodike të punës, për nëpunësit civil; përditësimin, sistemimin e dokumentacionit të dosjeve personale të punonjësve.
- Në zbatimin e akteve ligjore e neligjore në dokumentimin e formatizimin e dokumentave bazike të evidentimit të riskut dhe strategjive për menaxhimin e tij, formalizimin e zyrtarizimin e aktiviteteve të kontrollit si dhe raportimit e mbikqyrjes .
- Në kryerjen e angazhimeve për përmirësimin e veprimtarisë së këtyre subjekteve në zgjidhjen e plote të aksiomes “kush ben/cfare” .

- Opinion i auditimit mbi nivelin e besueshmërisë së kontrolleve të brendshme

Opinion i Vlerësimit të Sistemit të Kontrolleve të Brendshëm	Përshkrimi i Opinionit, baza e Opinionit
<p>Niveli 3 - Sistem Pjesërisht Efektiv:</p> <p>“Sistemi i Kontrollit të Brendshëm nuk funksionon plotësisht në mënyrë efektive/mirë dhe ka nevojë për përmirësime të rëndësishme, thelbësore”.</p> <p>Portokalli - </p>	<p>Sistemi i Kontrollit të Brendshëm funksionon pjesërisht në mënyrë efektive, ka mangësi serioze të cilat ekspozojnë njësitë e audituara ndaj risqeve të larta. Ka nevojë për marrjen e veprimeve të rëndësishme për përmirësime thelbësore në shumë drejtime.</p>

VII. PROGRAMI I SIGURIMIT TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL

Drejtuesit të kësaj njesie, në zbatim të Standardit 1300 të IIA, përcaktuar në Kapitullin e III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, është përpjekur të kryejë monitorimin e sistemit dhe sigurimin e cilësisë në të gjitha fazat e kryerjes së auditimit, pra që në planifikim, zbatim dhe raportim. Sigurimi i cilësisë është bërë pjesërisht nga drejtuesi i Sektorit A.B , nëpërmjet plotësimit të formateve standarte për të gjitha fazat me informacion të dobishëm e të besueshëm, sipas kërkesave të MAB për sigurimin e brendshëm të cilësisë të AB për bashkinë Kucove.

Sektori i auditimit për vitin 2025, ka konsideruar si mangësi hartimin e miratimit të Programit të Sigurimit të cilësisë së auditimit për NJAB Kucove, pasi nuk kemi të qartësuar modelin format.

Njeheresh eshte me vend te pohojme se, Përgjegjësi i Sektorit te AB ka qënë dhe vetë pjesmarës në grupin e auditimit,dhe nuk ka në personelin e NJAB Kucove, tjetër auditues të certifikuar për te realizuar rishikimin e veprimtarise audituese.

- *Trajnime dhe certifikime të realiuara*

Te 3 punonjesit e NJAB Kucove kane marre pjese ne trajnimet e zhvilluara e organizuara nga DH/AB , ne muajt Qershor dhe Tetor 2025.Në përfundim të dy trajnimeve online të zhvilluara, audituesit e NjAB-së janë pajisur me certifikatë të pjesëmarrjes vetëm për trajnimin e organizuar në muajin Tetor 2025.

Dhe pse për vitin 2025 nuk ka patur një Program për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë,ne forme dokumenti Përgjegjës grupi dhe drejtuesi i NjAB-së, kanë kryer monitorimin e sistemit dhe sigurimin e cilësisë në të gjitha fazat e kryerjes së auditimit, planifikim, zbatim dhe raportim. Dokumentimi i kontrollit të cilësisë i kryer gjatë të gjitha fazave të angazhimit të auditimit,është bërë sipas formularëve standard të miratuar.

VIII. KONKLuzionet dhe Rekomandimet e Përgjithshme

Prioritetet e Nj.A.B Kucove për vitin 2026 :

- Përmirësimi i kapaciteteve profesionale audituese, pasi që është plotësuar struktura e domosdoshme ligjore prej 3 punonjesh, si dhe vijimi i përpjekjeve të mireorientuara të punonjeshve të kësaj njesie ,për të bërë të mundur procesin e certifikimit të audituesve dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në trajnimet e organizuara nga DH/AB në vijim.
- Plotësimi e përmirësimi i kuadrit rregullator që normojnë veprimtarinë e NJAB Kucove, nëpërmjet rishikimit e përditësimit të dokumentave standard ligjor si Karta e Auditimit, Kodi i Etikës së audituesve të brendshëm, përmirësimi i Rregullores së Brendshme etj.
- Kryerja e angazhimeve audituese me cilësi,efektivitet dhe profesionalizem me qëllim suportin e kësaj njesie në arritjen e objektivave që bashkia Kucove ka për vitin 2026.
- Implementimi i korrekt dhe zgjedhja e procedurave apo metodave të përshtatshme të auditimit, të parashikuara në “Manualin e Auditimit të Brendshëm” miratuar me Urdhërin e MF nr.134 datë 17.10.2025, për arritjen e qëllimit të këtij shërbimi.
- Zbatimi i Standardeve Globale të auditimit të njohura ndërkombëtare dhe të miratuara nga Ministri i Financave, si dhe respektimi i Kodit të Etikës në komunikimin me subjektet që do auditohen dhe bashkëpunimi me grupet e interesit gjatë procesit të auditimit.
- Ofrimi i shërbimit të këshillimit për drejtuesit e bashkise për ato sisteme apo fusha të veprimtarisë që gjykohet nevoja për përmirësim dhe nëpërmjet një ekspertize profesionale dhenie opsionesh e rekomandime të specializuara.

SEKTORI I AUDITIMIT TE BRENDSEHEM

Adriatik CARKA

IX. PASQYRA SHOQËRUESE TË TË DHËNAVE

Pasqyra Shoqëruese të të Dhënave, ku prezantohen tabela dhe statistika të detajuara për auditimet dhe rekomandimet,

1. Pasqyra Nr.1: Të dhëna për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm për vitin;
2. Pasqyra Nr.2: Realizimi i planit të angazhimeve për vitin;
3. Pasqyra Nr.3: Përmbledhëse e gjetjeve me efekt negativ financiar sipas sistemeve për vitin;
4. Pasqyra Nr.4: Përmbledhëse e parregullsive të identifikuara sipas sistemeve për vitin;
5. Pasqyra Nr.5: Çështjet e dërguara për inspektim për vitin.

Plotësimi i pasqyrave do t'i shërbejë hartimit të pjesës së shkruar të Raportit Vjetor të NJAB. Të dhënat e paraqitura në pasqyra duhet të gjejnë argumentim të detajuar në pjesën e shkruar të dokumentit dhe kur është e nevojshme mund të bëhen dhe shënime shtesë në fund të materialit të përgatitur.

Pasqyrat e Raportit Vjetor plotësohen në Programin EXCEL.

Pasi të plotësohet pasqyrat duhet të siglohen nga drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm.

ANEKSI 5: RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Formati Standard Nr. 2:Të dhëna për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm

INSTITUCIONI Bashkia Kuçove
NIVELI I ORGANIZIMIT TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
SEKTOR
VARËSIA E NJËSISË SË AUDITIMIT BRENDSHËM
KRYETARI I BASHKISË
NUMRI I PUNONJËSVE NË ORGANIKË
3 (tre)

Të dhëna për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm për vitin

NR	EMËR MBIEMËR	TË DHËNA PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM								
		Pozicioni	Emërimi nr._ dt._	Arsimi Bazë	Niveli i Diplomës	Eksperiencia e Punës		Çertifikimi		
						Vitet e Punës Gjithsej	Vitet e Punës në AB	I pa certifikuar	Në proces certifikimi	I certifik në vit
a.	b.	1	2	3	4	5	6	7.1	7.2	7.3
1	Adriatik Carka	P/NJAB	15.12.2021	I Larte	Mast/Shkenc	27	4			Certifiku 2023
2	Enkeleda Ferro	Auditues	05.01.2021	I Larte	Mast/Profesio	9	5	pacertifikuar		
3	Eleonora Lacka	Auditues	12.12.2022	I Larte	Mast/Profeio	3	3	pacertifikuar		

Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm
_Adriatik Carka

Pasqyra Nr. 1: “Të dhëna për burimet njerëzore të auditimit të brendshëm për vitin”

Kjo pasqyrë shoqëron raportin vjetor të veprimtarisë së NjAB dhe do të plotësohet për periudhën Janar – Dhjetor të vitit raportues.

Kreu i pasqyrës: “Institucioni”, në këtë pjesë do të përcaktohet njësi publike, në të cilin funksionon njësi e auditimit të brendshëm, e cila po raporton.

“Niveli i organizimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm” do të tregojë nivelin organizativ të NjAB që mund të jetë: drejtori, sektor, zyrë, që është e përcaktuar në strukturën e miratuar për çdo njësi publike.

“Varësia Njesisë së Auditimit të Brendshëm” do të përcaktojë varësinë e NjAB nga menaxhimi i njësisë publike përkatëse, që duhet të jetë titullari i njësisë publike ose titullari i njësisë në shoqëritë tregtare sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar.

“Numri i Punonjësve në Organikë” do të jetë numri i punonjësve të NjAB të miratuar në organikën e njësisë publike pavarësisht nëse ekzistojnë vende vakante.

Kolona b) “Emër Mbiemër” do të përfshijë emrat e të gjithë punonjësve aktual të NJAB nga drejtuesi i NJAB deri tek punonjësi më i ri në këtë njësi.

Kolona 1) “Pozicioni”, do të tregojë pozicionet e punës sipas nivelit aktual për çdo pjesëtar të stafit të NjAB (p.sh.: drejtor, shef sektori, inspektor, specialist, etj.).

Kolona 2) “Emërimi” do të paraqesë për secilin punonjës të NJAB urdhërin/vendimin/shkresën me numër të saktë dhe datën e emërimit të punonjësit në pozicionin aktual.

Kolona 3) “Arsimi bazë” do të paraqesë për secilin punonjës të NjAB (titullin/emërtimi që është i specifikuar në diplomën e studimeve universitare të secilit, dega për të cilën ka studiuar personi. (P.sh. Ekonomist Finance, Jurist, Inxhinier, Mjek, etj.).

Kolona 4) “Niveli i Diplomës”, do të paraqesë për secilin punonjës të NjAB diplomën që zotëron (sipas ligjit të Arsimit të Lartë), si: Master i Nivelit të Dytë (Master Profesional ose Master Shkencor), Doktoraturë, etj.

Kolona 5) “Vitet e Punës gjithsej” do të paraqesë vitet e punës të të gjithë punonjësve të NJAB.

Kolona 6) “Vitet e Punës në Auditim” do të paraqesë vitet e punës vetëm në strukturat audituese të të gjithë punonjësve të NJAB.

Kolona 7.1) “I pa certifikuar”, në këtë kolonë do të identifikohen punonjësit e NjAB të cilët nuk e kanë kryer trajnimin e detyrueshëm për t’u certifikuar si “Auditues i Brendshëm në sektorin publik” – certifikatë e lëshuar ose e njohur vetëm nga ministria përgjegjëse për financat.

Kolona 7.2) “Në proces certifikimi” do të tregojë nëse punonjësit e NjAB janë duke vazhduar trajnimin e detyrueshëm për t’u certifikuar si “Auditues të Brendshëm në sektorin publik”.

Kolona 7.3) “I certifikuar në vitin_____” do të përcaktojë numrin personal dhe vitin në të cilin punonjësit e NjAB e kanë kryer trajnimin e detyrueshëm për t’u certifikuar si “Auditues të Brendshëm në sektorin publik”.

Kolona 7.4) “Certifikatë Ndërkombëtare” - nga Institucione Kombëtare ose Ndërkombëtare

Kolona 7.5) “Trajnime në fushën AB - nga Institucione Kombëtare ose Ndërkombëtare”, ka të bëjë me trajnimet e zhvilluara në fushën e auditimit nga Institucione Kombëtare ose Ndërkombëtare për periudhën që po raportohet. Këtu nuk përfshihen trajnimet e organizuara nga struktura përgjegjëse për auditimin e brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat.

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË Bashkine Kucove

Pasqyra 2

Realizimi i planit të angazhimeve për vitin 2025

Në numër

Nr	Subjekte të audituara nga NJAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit												
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre									Statusi i Angazhimit		Buxheti i Audituar për Subjekt (vetëm për vitin e fundit)	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbime Këshillimi	Angazhime me kërkesë të titullarit	Angazhime të përfunduara	Angazhime në proces	Në 000 lekë	Në % sipas buxhetit të njësisë/subjektit	
			A. të përputhshmërisë	A. të performancës	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. te Kombinuara							
a.	1	(3.1+3.2+3.3+3.4+3.5+3.6+3.7) ose (4.1+4.2)	3.1	3.2	3.3	3.4	3.5	3.6	3.7	4.1	4.2	5.1	5.2	
1	Dr.Qendra Kulturore	1				1				1		15.437	2.7 %	
2	Inspek Mbrojtjes Territorit	1	1							1				
3	Zbatimit te Rekomandimeve	1	1							1				
4	Spektori i Prokurimeve	1	1							1				
5	Qendra Ekonomike Arsimit	1				1				1		190.437	27.4%	
6	Dr.Ardhurave Vendore	1	1							1				
	Totali	6	4			2				6				

Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm Adriatik Carka

Pasqyra Nr. 2: “Realizimi i planit të angazhimeve për vitin”

Kolona 1): “Subjekte të audituara nga NJAB” do të jetë një listë e të gjitha subjekteve që NjAB ka audituar gjatë vitit.

Kolona 2): “Gjithsej” do të jetë një kolonë e cila do të mbledhë të gjitha auditimet e realizuara dhe do të operojë me komandë (formulën përkatëse). Kjo do të llogaritet si shumë aritmetike e kolonave 3 pra (3.1+3.2+3.3+3.4+3.5+3.6+ 3.7).

Kolona 3): “Auditime të realizuara sipas llojit të tyre” do të tregojë auditimet të ndara sipas llojit që janë realizuar gjatë vitit. Në kolonat 3.1 - 3.5 do të përfshihen auditimet e realizuara në shërbimet e sigurisë, si: auditime të përputhshmërisë, auditime të performancës, auditime financiare, auditime të teknologjisë së informacionit dhe auditim i sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në Kolonën 3.6) “Shërbime këshillimi” do të përfshihen auditime për shërbime këshillimi për menaxhimin e njësisë publike.

Në Kolonën 3.7) “Angazhime me kërkesë të titullarit” do të përfshihen të gjitha angazhimet e auditimit që bëhen me kërkesë të titullarit të njësisë publike dhe nuk janë të planifikuara në planin vjetor të angazhimeve.

Kolona 4) “Statusi i Angazhimit” janë përfshirë të dhëna për 4.1 “**Auditime të përfunduara**” dhe 4.2 “**Angazhime në proces**”.

Në kolonën 4.1, do të përfshijë të dhëna mbi angazhimet e përfunduara.

Në kolonën 4.2, do të përfshijë numrin e subjekteve që janë audituar dhe dosjet e punës janë në proces.

Kolona 5 “Buxheti i audituar për subjekt”, janë përfshirë 5.1 “buxheti i audituar në 000 lekë” dhe 5.2 “në % të buxhetit të subjektit”. Të dhënat do jenë vetëm për periudhën e vitit aktual, pra vitin e fundit.

Kolona 5.1) do përfshijë vlerën totale të buxhetit të audituar tek njësia

Kolona 5.2) do të përfshijë sa % zë buxheti i audituar në krahasim me buxhetin e institucionit

ANEKSI 5: RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Formati Standard Nr. 4: Përmbledhëse e gjetjeve me efekt negativ financiar sipas sistemeve **Pasqyra Nr.3.**

Përmbledhëse e gjetjeve me efekt negativ financiar sipas sistemeve për vitin 2025

000/lekë

Subjekte të audituara nga NJAB	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMIT										Shuma me efekt negativ financiar
	Qeverisja dhe administrimi	Planifikimi dhe buxhetimi	Prokurimi	Menaxhimi Burimeve Njerëzore	Pagat dhe shpërblimet	Raportimi Financiar dhe Kontabiliteti	Aktivet e Qëndrueshme	Detyrimet e prapambetura	Të ardhurat	Sisteme specifike operacionale të subjektit	
1	2.1	2.2	2.3	2.4	2.5	2.6	2.7	2.8	2.9	2.10	3
Totali	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm Adriatik Carka

Pasqyra Nr.3. “Përmbledhëse e gjetjeve me efekt negativ financiar sipas sistemeve për vitin”

Ky format i shërben identifikimit të gjetjeve me efekt negativ financiar të ndara sipas sistemeve të realizuara nga NjAB gjatë auditimeve të kryera, subjektet në të cilat është realizuar gjetja, dhe vlera në **000/lekë** e dëmit ekonomik.

Duhet theksuar se gjetjet me dëm ekonomik/ efekt negativ financiar nuk janë qëllim i punës së auditimit të brendshëm. Kur audituesi konstaton dëm ekonomik/ me efekt negativ financiar në kampionin e përzgjedhur nuk bën kërkime dhe përlllogaritje të mëtejshme për të nxjerrë vlerën e plotë të dëmit. Audituesit e brendshëm duhet të japin rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike / me efekt negativ financiar për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes.

Kolona 1): “Subjektet e audituara” do të jetë lista e subjekteve që NjAB ka audituar dhe në të cilat kanë rezultuar gjetje me dëm ekonomik, të cilat duhet t’i kthehen buxhetit të shtetit.

Kolonat 2) (2,1+ 2,2 + 2,3+ 2,4 + 2,5 + 2,6 + 2,7 + 2,8 + 2,9 + 2,10) “Gjetjet sipas fushës ose sistemit”, në secilën kolonë do të regjistrohen të gjitha gjetjet me efekt negativ financiar të realizuara gjatë auditimeve, të ndara nëpër kolona sipas sistemeve. **Sistemet do të përcaktohen nga vetë NJAB sipas gjetjeve të evidentuara.**

Shembuj sistemesh: qeverisja dhe administrimi, planifikimi dhe buxhetimi, prokurimi, menaxhimi burimeve njerëzore, pagat dhe shpërblimet, raportimi financiar dhe kontabiliteti, aktivet e qëndrueshme, detyrimet e papaguara, te ardhurat nga taksat, si dhe çdo sistem specifik operacional i subjektit të audituar në të cilin kanë rezultuar gjetje.

Kolona 3) “Shuma me efekt negativ financiar”, do të jetë një kolonë e cila do të mbledhë të gjitha gjetjet me dëm ekonomik të specifikuar në secilin sistem dhe do të operojë me komandë (formulën përkatëse). Kjo do të llogaritet si shumë aritmetike e kolonave **(2,1+ 2,2 + 2,3+ 2,4 + 2,5 + 2,6 + 2,7 + 2,8 + 2,9 + 2,10).**

ANEKSI 5: RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Formati Standard Nr. 5: Përmbledhje e gjetjeve sipas sistemeve dhe nënsistemeve

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË Bashkine Kucove

Pasqyra 4

Përmbledhje e gjetjeve sipas sistemeve dhe nënsistemeve

		Në numër	
Sistemi / Nën sistemi ku është konstatuar gjetja		Gjetjet e identifikuara numër	Gjetjet e identifikuara në % kundrejt totalit
1 Qeverisja dhe administrimi	1.1 Planifikimi Strategjik, Objektivat Planet vjetore dhe operacionale		
	1.2 Vendimmarrja dhe mbikëqyrja		
	1.3 Menaxhimi i Riskut		
	TOTALI: Qeverisja dhe administrimi	10	19.6%
2 Planifikimi dhe buxhetimi	2.1 Planifikimi Buxhetor		
	2.2 Zbatimi Buxhetit		
	2.3 Monitorimi zbatimit Buxhetit Shtetit		
	2.4 Rishikim Buxhetit		
	TOTALI Planifikimi dhe buxhetimi	0	0%
3 Prokurimi	3.1 Planifikimi		
	3.2 Procesi tenderimit		
	3.3 Kontraktimi		
	3.4 Apelimi		
	3.5 Zbatimi		

	3.6 Dorëzimi		
	3.7 Punime të tjera shtesë		
4 Menaxhimi Burimeve Njerëzore	TOTALI Prokurimi	3	5.9%
	4.1 Rekrutimi		
	4.2 Largimi/Lirimi		
	4.3 Etika		
	4.4 Trajnimi Profesional		
	4.5 Mungesa e stafit		
	4.6 Aftësitë profesionale		
	TOTALI Menaxhimi Burimeve Njerëzore	5	9.8%
5 Pagat dhe shpërblimet	5.1 Përlllogaritja e pagave		
	5.2 Pagesat e taksave dhe kontributi sig. shoqërore		
	5.3 Dietat dhe honorarë		
	5.4 Efektiviteti kohës së punës		
	TOTALI Pagat dhe shpërblimet	0	0%
6 Raportimi Financiar dhe Kontabiliteti	6.1 Kontrolle/rregullat /procedurat e angazhimit		
	6.2 Kontrollat e Thesarit		
	6.3 Pagesat		
	6.4 Mbikëqyrja afateve		
	6.5 Rakordimet		
	6.6 Regjistrimet në kontabilitet		
	6.7 Saktësia Raportimit		
	TOTALI Raportimi Financiar dhe Kontabiliteti	0	0%
7 Aktivitet e Qëndrueshme	7.1 Plotësia		
	7.2 Ekzistenca		
	7.3 Saktësia		
	7.4 Mbyllja		
	7.5 Inventarët		
	7.6 Amortizimi		
	TOTALI Aktivitet e Qëndrueshme	4	7.8%
8 Detyrimet e prapambetura	8.1 Plotësia		

	8.2 Ekzistenca		
	8.3 Regjistrimi		
	TOTALI Detyrimet e prapambetura	4	7.8%
9 Të ardhurat	Vlerësimi		
	Arkëtimi dhe mbledhja		
	Regjistrimi/kontabilizimi		
	Rakordimi		
	Llogarite e arketueshme/ mbledhja e detyrimeve		
	Raportim		
	TOTALI Të ardhurat	2	3.9%
10 Sisteme specifike operacionale të subjektit (ne kete pjese do te specifikohen nensistemet qe jane vetem per institucionin qe auditohet. P.sh. Ne nje ender spitaloe : Manaxhimi pacentt, sherbimi farmaceutik, Ne nje Universitet: Sistemi Bursave studentore, Kerkimi shkencor etj.	10.1		
	TOTALI Sistem Specifik	23	45.1%
<i>Gjetjet ne total per vitin : Qeverisja dhe administrimi+ Planifikimi dhe buxhetimi+ Prokurimi +Menaxhimi Burimeve Njerëzore +Pagat dhe shpërblimet +Raportimi Financiar dhe Kontabiliteti + Aktivitet e Qendrueshme+Detyrimet e prapambetura+Të ardhurat + Sistem Specifik</i>			

Drejtuesi I Auditimit të Brendshëm Adriatik Carka

Pasqyra Nr. 4: “Përmbledhje e gjetjeve sipas sistemeve dhe nënsistemeve”;

Ky format i shërben për përmbledhjen e gjetjeve sipas sistemeve/ nënsistemeve.

Kolona 1) “Gjetjet e identifikuar numër” do të vendosen shuma totale e gjetjeve të rezultuara në auditimet e kryera gjatë vitit nga NJAB sipas Sistemit / Nënsistemit ku është konstatuar gjetja.

Kolona 2) “Gjetjet e identifikuar në % kundrejt totalit” këtu do të përcaktohet se sa është shuma e gjetjeve për secilin nënsistem kundrejt totalit të gjetjeve. Vlerë kjo që do dalë me %.

ANEKSI 5: RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Formati Standard Nr. 6: Çështjet e Dërguara për Inspektim

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË Bashkine Kucove

Pasqyra 5

Çështjet e dërguara për inspektim për vitin 2025

Nr.	Subjektet ku janë konstatuar parregullsitë	Shkresa Referuese (nr, datë)	Natyra e parregullsisë ose veprime që përbëjnë vepër penale	Autoriteti ku janë dërguar praktikant për ndjekje
a.	1	2	3	4
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				

Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm Adriatik Carka

Pasqyra Nr. 5 “Çështje të dërguara për inspektim për vitin”

Ky format i shërben identifikimit të çështjeve të dërguar për investigim të mëtejshëm nga organet përkatëse për periudhën për të cilën po raportohet.

Kolona 1): “Subjektet ku janë konstatuar parregullsitë”, do të jetë lista e subjekteve që NjAB ka audituar dhe në të cilat kanë rezultuar parregullsi ose veprime që në vlerësimin e NJAB përbëjnë vepër penale dhe kanë nevojë për një investigim të mëtejshëm nga organe të specializuara si: Inspektimi Financiar, etj. Në lidhje me këtë kërkohet raportim i menjëhershëm në formë të shkruar tek titullari i njësisë publike.

Kolona 2): “Shkresa Referuese (nr. datë)”, do të jetë shkresa ku përcaktohet numri i protokollit dhe data në të cilën është nisur inspektimi i mëtejshëm në organin e përcaktuar, nga titullari i njësisë publike.

Kolona 3): “Natyra e parregullsisë ose veprime që përbëjnë vepër penale”, do të shpjegohet shkurt, saktë dhe sa më qartë natyra e parregullsisë së konstatuar sipas rastit.

Kolona 4): “Autoriteti ku janë dërguar praktikat për ndjekje”, do të jetë e përcaktuar se kujt organi i janë drejtuar këto çështje për ndjekje, pra: Inspektimit Financiar, etj.

